

## Fjala e Drejtores së Përgjithshme të Institutit të Statistikave, Znj. Delina Ibrahimaj

**Tiranë, më 04 Shtator 2018:** Përshëndetje Z. Ministër i Financave, Z. Storke dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë që na janë bashkuar sot, në konferencën përmbyllëse të projektit "Mbështetje për Përmirësimin e Sistemit të Informacionit Statistikor në Shqipëri", të financuar nga Bashkimi Evropian.

Është një kënaqësi e veçantë për mua të jem me ju sot, për t'ju prezantuar rezultatet e një pune disavjecare në implementimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm, i cili ka vendosur një gur themeli në përmirësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Projekti, përmes komponentëve të tij dhe punën e dedikuar në grup, për të arritur objektivat e përcaktuara dhe për të sjellë rezultate të shkëlqyera, ka qenë një mbështetje e madhe për INSTAT si dhe gjithë Sistemin Statistikor në Shqipëri.

Sot, mund t'i gëzohemi arritjeve së bashku me partnerët tanë, palët e interesit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në zbatimin e këtij projekti.

Ky projekt, i mirë strukturuar ka sjellë rritje të efektivitetit të punës së INSTAT, përmes zbatimit të implementimit të 3 komponentëve kryesorë. Duke u përqëndruar në përmirësimin e proceseve kyçe të prodhimit statistikor, projekti ka mundur që INSTAT të zbatojë strategjitë dhe programet e tij, duke bërë kështu një hap edhe më pranë përputhshmërisë së prodhimit statistikor me standardet evropiane.

Projekti, u realizua përmes një sërë aktiviteteve që përmirësuan proceset tona të prodhimit, infrastrukturën tonë të IT-së, si edhe zgjeruan përpjekjet tona të shpërndarjes së informacionit, përmes strategjive dhe mjeteve moderne të komunikimit.

Gjatë dy viteve të fundit, ekipet ndërkombëtare dhe lokale kanë punuar së bashku duke kapërcyer sfida, zbatuar me kujdes dhe përkushtim planin e veprimit, si edhe duke monitoruar me kujdes dhe përshtatur burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme. Implementimi i këtij projekti na ka ndihmuar të përmirësojmë kapacitetet menaxhuese të institucionit, pa lënë mënjanë ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me ekspertë të fushave të ndryshme dhe agjenci simotra ndërkombëtare, në veçanti me zyrën statistikore të Republikës së Serbisë.

Sistemi statistikor është në themelin e zhvillimit të një vendi demokratik, ku vendimet dhe politikat hartohen bazuar në shifra. Duke pasur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e vendit, modernizimi i tij dhe rritja e kapaciteteve institucionale të prodhimit statistikor kanë qenë dhe do të jenë një prioritet kryesor.

Rezultatet pozitive të projekteve të tilla, janë dëshmi e vërtetë e potencialit tonë, vullnetit tonë të mirë dhe angazhimit për t'u rritur si profesionistë, si njerëz dhe si komunitet.

Ne i jemi thëllësisht mirënjohës, Bashkimit Evropian për mbështetjen në ndërtimin e instrumenteve të tilla të vlefshme, si dhe për mundësinë për të zbatuar dhe përfituar si një komunitet.

Dëshiroj gjithashtu të falënderoj të gjithë partnerët tanë që ishin pjesë e këtij projekti:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila në cilësinë e saj si autoriteti kontraktues, na ka mbështetur në zbatimin procedural të këtij projekti.
- Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, i cili na ka mbështetur në çdo hap.
- Konsorciumi implementues i udhëhequr nga Ascenta IT Services, në bashkëpunim me IN2 Zagreb dhe ekipi i ekspertëve të saj
- E fundit por jo më pak e rëndësishme, stafi i INSTAT-it, i cili i është dedikuar plotësisht këtij projekti, duke mos lënë mënjane punën dhe përgjegjësitë e përditshme.

Duke ju falenderuar përsëri, mbetemi të hapur për bashkëpunime të tjera të frytshme në të ardhmen.